Kampionati Europian 2026

Gjimnastikë Artistike për Femra - Juniore

Arena Zagreb, Kroaci | 9–15 gusht 2026

RAPORT I GARËS

Përgatitur nga Arlind Shaqiri

1. Përmbledhje

Federata e Gjimnastikës e Kosovës mori pjesë me tri gjimnaste juniore në Kampionatin e 36-të Evropian në Gjimnastikë Artistike për Femra, të mbajtur në Zagreb të Kroacisë. Delegacioni qëndroi në Zagreb nga 9 deri më 15 gusht 2026, duke realizuar stërvitje sipas kërkesës, stërvitje të planifikuara, stërvitjen zyrtare në podium dhe garën kualifikuese të juniorëve më 14 gusht. Gjimnastet përfaqësuese ishin Sara Pllana, Rea Berisha dhe Jora Gërvalla. Pjesëmarrja përbën përfaqësimin e dytë të Kosovës në Kampionatin Evropian të Gjimnastikës Artistike për Femra dhe paraqet një hap të rëndësishëm për zhvillimin e sportisteve juniore, ngritjen e kapaciteteve profesionale të stafit dhe konsolidimin e pranisë së FGJK-së në aktivitetet e European Gymnastics.

Delegacioni i Federatës së Gjimnastikës së Kosovës përbëhej nga:

Emri dhe mbiemri	**Roli / veglat**
Sara Pllana	Gjimnaste : parter dhe tra
Rea Berisha	Gjimnaste : parter dhe tra
Jora Gërvalla	Gjimnaste : parter dhe kapërcime
Abeliana Bregu	Trajnere
Arlind Shaqiri	Trajner
Beriana Makolli	Fizioterapeute

Gara u organizua nga Gjimnastika Europiane, ndërsa Federata pritëse (host federation) ishte:
Croatian Gymnastics Federation, me person kontaktues: Mr Vladimir Madarevic, adresa:
Kršnjavoga 1 - 10000 Zagreb – Kroaci, Tel: +385 1 301 2324
Lokacioni i garës**:** Arena Zagreb,Vice Vukova 8, 10000
Kapaciteti i sallës: 5,000
Distanca nga hotelet e delegacioneve: rreth 5 km

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION



Kampionati Evropian në Gjimnastikë Artistike për Femra është një nga aktivitetet kryesore kontinentale të European Gymnastics. Edicioni i Zagrebit ishte edicioni i 36-të dhe përfshiu gara për seniore dhe juniore. Sipas formatit të kampionateve në vitet çift, programi përmban kualifikimet e seniorëve dhe juniorëve, finalet në vegla për të dy kategoritë dhe finalen ekipore të seniorëve. Në kategorinë juniorë, rezultatet e kualifikimeve përcaktojnë njëkohësisht renditjen ekipore, renditjen individuale në shumëgarësh dhe kualifikimin në finalet e veglave.

Të dhënat e mëposhtme janë vetëm për junior femra dhe janë paraqitur nga organizatori në takimin zyrtar orientues (orientation meeting). Numri total prej 39 federatash përfshin delegacionet e regjistruara në programin e femrave; disa federata morën pjesë në njërën kategori, ndërsa të tjera në të dyja.

39	**293**	**36**	**130**
federata kombëtare	Gjimnaste junore gjithsej	federata te juniorët	gjimnaste juniore

Gara u zhvillua në Arena Zagreb, që është objekti më i madh i mbyllur sportiv në Kroaci dhe ka kapacitet maksimal deri në rreth 15,000 spektatorë. Organizatori e përdori të njëjtin kompleks për fushën e garës, sallën e nxehjes dhe hapësirat e stërvitjes,



Planifikimi zyrtar i Arena Zagreb: fusha e garës, salla e nxehjes dhe hapësirat e stërvitjes.

Burimi: Direktivat WAG ECh Zagreb 2026.

Në takimin orientues mori pjesë Abeliana Bregu, ndërsa në të njejten kohë zhvilloheshin ushtrimet e gjimanstikës, ku Arlind Shaqiri merrej me stërvitjen e gjimnasteve. Takimi orientues përcaktoi hyrjet e sportisteve, zonat e prezantimit, hapësirën Kiss & Cry, zonat mjekësore, tavolinat e kërkesave teknike dhe rrjedhën e hyrje-daljes nga fusha e garës. Cka u spjegua me rëndësi ishte që sportistet duhej të rreshtoheshin pesë minuta para prezantimit; trajnerët, fizioterapeutët dhe zyrtarët hynin në fushë para sportisteve me pajisjet e delegacionit. Prezantimi ishte i detyrueshëm edhe për sportistet që nuk garonin në të gjitha veglat. Pjesëmarrja e delegacionit të FGJK-së në kampionate kontinentale forcon bashkëpunimin e federatës me strukturat evropiane të gjimnastikës.

2. Udhëtimi, akomodimi dhe logjistika

Ekipi u nis nga Prishtina më 9 gusht 2026, në orën 01:00, me minibus drejt Aeroportit Ndërkombëtar të Shkupit. Fluturimi Croatia Airlines nr. 367 u nis në orën 05:20 dhe arriti në Zagreb në orën 06:35. Delegacioni u prit nga transporti i organizatorit dhe u dërgua në Hotel International Zagreb. Check in u bë nga ora 10:00, ku ekipi kishte kohë mjaft të pushonte deri pasdite kur ishin stërvitjet e para. Me të arritur në hotel ekipi u prit nga organizatorët dhe u ofruan canta me dhurata të vogla dhe akreditime. Ekipi u akomodua në dy dhoma me nga dy shtrata dhe dy dhoma tjera me nga një shtrat.
Në ditën e mbërritjes u shërbyen dreka dhe darka në hotel, ndërsa nga dita e dytë e tutje edhe mëngjesi. Oraret standarde të vakteve ishin: mëngjesi 06:30 deri 10:00, dreka 11:30 deri 15:30

dhe darka 18:30 deri 22:30. Salla ishte rreth 20 minuta larg hotelit me autobus dhe transporti zyrtar funksiononte afërsisht çdo orë në të dy drejtimet.
Organizatori kishte paraparë shërbim mjekësor dhe autoambulancë në palestër, tavolina fizioterapie dhe pajisje terapeutike në zonën mjekësore, si dhe akull në sallën e stërvitjes. Uji sigurohej përmes pikave të rimbushjes në sallat e stërvitjes dhe nxehjes. Kontrolli antidoping zhvillohej nën drejtimin e International Testing Agency.
Më 15 gusht 2026 delegacioni u nis nga Zagrebi me fluturimin Croatia Airlines nr. 366 në orën 22:15 dhe mbërriti në Shkup në orën 00:30. Udhëtimi vazhdoi me transport tokësor drejt Kosovës. Në orët e hershme të mëngjesit të datës 16 gusht ekipi mbërriti në Prishtinë.

3. Kronologjia e aktivitetit

Data	Aktiviteti	Përshkrimi
9 gusht	Mbërritja dhe Training on Request	Akomodimi; stërvitje e aprovuar paraprakisht nga European Gymnastics në orën 18:30; ngarkesë e lehtë pas udhëtimit.
10 gusht	Scheduled Training – Juniorë	Grupi 4; nxehje 17:30–17:50 dhe punë në vegla 17:50–20:10.
11 gusht	Scheduled Training – Juniorë	I njejti orar. U vërejt përgatitje e mirë dhe rritje e besimit për paraqitjen në garë.
12 gusht	Podium Training – Juniorë	Hyrja në sallën e nxehjes 16:15; nxehja deri 17:45; hyrja në FOP 17:50–18:00; veglat 18:00–20:00.
13 gusht	Scheduled Training – Juniorë	Grupi 4, 17:30–20:10. Ekipit iu bashkuan kryetari Shkumbin Maqastena dhe nënkryetarja e FGJK-së Sherife Qerimi.
14 gusht	Kualifikimet – Juniorë	Nënndarja 4; nxehja 16:15–17:45; hyrja 17:50–18:00; gara 18:00–20:05.
15 gusht	Përfundimi dhe kthimi	Nisja nga Zagrebi në orën 22:15, mbërritja në Shkup 00:30 dhe vazhdimi drejt Kosovës.

Podium training ishte simulimi më i afërt me garën dhe përdoret nga ekipet për përgatitjen e procedurës së hyrjes, nxemjeve, prezantimit, rotacionit dhe daljes. Për grupet e përziera, organizatori mat kohën në paralele dhe tra në mënyrë që secila sportiste të marrë kohë të barabartë. Në tra dhe parter, touch warm-up është 30 sekonda për sportiste; kur grupi ka më pak se tri sportiste, garantohet së paku 1 minutë e 30 sekonda nxehje. Gjatë garës ndalohej përdorimi i telefonave dhe pajisjeve të komunikimit nga sportistet, trajnerët dhe stafi mjekësor; lejohej fotografitë pa blic, por jo videot, nëse nuk pengohet gara. Thirrjet dhe brohoritjet e trajnerit lejohejn në stërvitje, por jo gjatë garës. Gjimnastet mund të ktheheshin në sallën e nxehjes, por ishin vetë përgjegjëse të rikthehen në kohë për ushtrimin e tyre. Këtë rregull e kemi përdorur ne, pasi që pas përfundimit të garës apo ushtrimeve në parter, kishim kohë shumë deri sa vinte koha e traut, pasi që në mes të këtyre dy veglave janë kapërcimet dhe paralelet ku dy gjimnaste nuk garuan në këto vegla.

Sportistet nuk kishin ndonjë lëndim të madh, dhe ishin të gatshme fizikisht për garë. Për këtë aspekt u përkujdes fizioterapeutja e ekipit.

Me date 13 gusht nga ora 18:50, Shkumbin Maqastena, Sherife Qerimi, Abeliana Bregu, Arlind Shaqiri dhe Beriana Makoolli ishin prezent si shikues në garën e Senioreve, deri te ceremonia e medaljeve në ora 21:30. Gjatë kësaj kohe gjimnatet tona pushuan për ditën e nesërme ku do të garojnë.

Dita e garës (14 gusht 2026):
Kosova garoi në nënndarjen apo subdivizionin e katërt, në grup me Belgjikën dhe Greqinë. Pas përfundimit të nxemjevedhe prezantimit zyrtar, rotacioni filloi në parter nga ora 18:00 deri në 18:31. Më pas grupi kaloi në kapërcime nga 18:31 deri në 19:02, në paralele nga 19:02 deri në 19:33 dhe në tra nga 19:33 deri në 20:05. Kosova nuk pati paraqitje në paralele. Arlind Shaqiri qëndroj afër gjimnasteve gjatë garës duke u kujdesur që gjithqka të shkoj me rregull.

Gjimnastja	Vegla	D	E	Pen.	Final	Rend.
Rea Berisha	Parter	3.400	6.933	–	10.333	91
Jora Gërvalla	Parter	3.200	5.666	−0.200	8.666	111
Sara Pllana	Parter	4.200	6.000	–	10.200	94
Jora Gërvalla	Kapërcime	2.600	8.233	−0.100	10.733	103
Rea Berisha	Tra	2.800	5.800	−0.100	8.500	106
Sara Pllana	Tra	4.400	6.233	–	10.633	72

Siç shihet nga rezultatet, paraqitja më e mirë u arrit në tra me pozitën e 72-të. Ky rezultat konsiderohet i dobët, veçanërisht po të krahasohet me përgatitjen e bërë nga gjimnastet dhe trajnerët, formën e arritur dhe konkurrencën. Kosova synonte këtë vit kualifikimin në finale, mirëpo gabimet gjatë garës, përfshirë rrëzimet jo të zakonshme, dhe faktorë të tjerë ndikuan në këtë rezultat përfundimtar. Ekipi duhet të punoj fort që të përmisohen këto rezultate në të ardhmen.
Në tabelën ekipore Kosova u regjistrua në vendin e 26-të, përkatësishte fundit dhe me shënimin DNF, pasi nuk kishte rezultat të plotë në katër veglat. Ky shënim lidhet me formatin e renditjes ekipore dhe nuk i anulon rezultatet individuale të arritura në veglat ku gjimnastet garuan. Nga këto rezultate mund të nxjerrim rekomandime të rëndësishme, e që kryesorja është që synohet përfaqësim në të katër veglat dhe krijimi i një rezultati ekipor të plotë në kampionatet e ardhshme.

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

4. Përfundim

Pjesëmarrja në Kampionatin Evropian 2026 në Zagreb u realizua me sukses nga aspekti organizativ dhe përfaqësues sepse delegacioni përmbushi programin e stërvitjeve dhe të garës, sportistet regjistruan rezultate individuale dhe stafi fitoi përvojë të drejtpërdrejtë me standardet teknike e operative të European Gymnastics, dhe gjimnatet nuk e morëm ndojnë lëndim. Rezultatet në përgatitje tregojnë që niveli i gjimnastikës është rritur shumë edhe pse rezultatet në këtë garë nuk treguan një gjë të tillë, por i tillë është sporti i gjimnastikës.

FGJK-ja shpreh mirënjohje për institucionet e Republikës së Kosovës, përkatësisht për Ministrinë e Sportit dhe Rinisë që mbështesin përfaqësimin e gjimnastikës në arenën ndërkombëtare.

Disa foto nga aktiviteti:



FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION













FGJK – KGF

Shtëpia e Sporteve, Rruga Agim Ramadani, 10000 Prishtinë, tel:044/145/009 email: kosovagymnasticsfederation@gmail.com

FEDERATA E GJIMNASTIKËS E KOSOVËS
KOSOVA GYMNASTICS FEDERATION



Rezultatet e plota të garës mund të gjenden në linkun:
https://www.europeangymnastics.com/event/2026-european-championships-womens-artistic-gymnastics-zagreb-cro/results

REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E SPORTIT
DHE RINISË

Data e raportit: 08.09.2026
Prishtinë